



Integriteti dhe Vendimmarrja: Faktorët që Ndikojnë në Sjelljen e Punonjësve të Administratës Publike

RAPORT KËRKIMOR

INTEGRITETI DHE VENDIMMARRJA FAKTORËT QË NDIKOJNË NË SJELLJEN E PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

RAPORT KËRKIMOR



**INTEGRITETI DHE VENDIMMARRJA: FAKTORËT
QË NDIKOJNË NË SJELLJEN E PUNONJËSVE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE
RAPORT KËRKIMOR**

Autoret:

Adela Danaj

Përpunimi statistikor dhe analiza:

Mimosa Agolli

Redaktor letrar:

Durim Tabaku

Dizajn dhe layout:

Eduart Cani

© 2024 nga Instituti për Demokraci dhe
Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1

1017 Tirana, Albania

E-mail: info@idmalbania.org

www.idmalbania.org



Institute
for Democracy
and Mediation



Suedi
Sverige

Ky dokument u hartua në kuadër të Projektit "Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike" zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (me mbështetjen financiare të Ambasadës së Suedisë në Tiranë. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Ambasadës së Suedisë.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE	5
1. PARASHTRIMI DHE KUADRI TEORIK	6
1.1 TEORIA E INTELIGJENCËS AFEKTIVE	6
2. MODELI EKSPERIMENTAL	8
2.1. FAZA E PARA-EKSPERIMENTIT	8
2.2 FAZA E EKSPERIMENTIT	8
2.3 FAZA E PAS-TRAJTIMIT	9
3. METODOLOGJIA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE	10
3.1. ANALIZA E DIFERENCËS NË EMOCIONET E KRIJUARA PAS STIMULIT NË GRUPIN EKSPERIMENTAL DHE TË KONTROLLIT (ANOVA)	10
3.2. ANALIZA E LIDHJES MES EMOCIONEVE TË KRIJUARA DHE NIVELIT TË INFORMACIONIT MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT	11
3.2.1. ANALIZA E LIDHJES MES NIVELIT TË INFORMACIONIT ME NJOHURITË POLITIKE DHE NJOHURISË MBI INTEGRITETIN DHE ETIKËN	12
3.2.2. ANALIZA E LIDHJES MES NIVELIT TË INFORMACIONIT ME NJOHURITË POLITIKE DHE TIPARET DEMOGRAFIKE	13
3.3. ANALIZA E LIDHJES MES EMOCIONEVE TË KRIJUARA ME REAGIMIN	14
4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	17
REFERENCAT	18
SHTOJCA I – PYETËSORI PARA-EKSPERIMENT	19
SHTOJCA II. SKENARI A PËR GRUPIN E EKSPERIMENTIT. PROCESI JO-ETIK I PROKURIMIT (NXITËSI I ANKTHIT)	24
SHTOJCA III. PYETËSORI POST-EKSPERIMENT PËR GRUPIN E EKSPERIMENTIT	25
SHTOJCA IV. SKENARI B PËR GRUPIN E KONTROLLIT. PROCESI ETIK I PROKURIMIT (NXITËSI I ENTUZIAZMIT)	26
SHTOJCA V – PYETËSORI POST- EKSPERIMENT PËR GRUPIN E KONTROLLIT	27
SHTOJCA VI – TABELAT E ANALIZËS	28

TABELA E GRAFIKËVE

Figura 1. Si ju bën të ndjeheni informacioni për procedurën e prokurimit?	11
Figura 2. Dallimi mes grupeve në raportin mes shkallës së emocioneve dhe nevojës për informacion	12
Figura 3. Shkalla e ndikimit të emocioneve në informimin mbi një procedurë prokurimi	14
Figura 4. Prevalenca e raportimit	16

TABELA E TABELAVE

Tabela 1. Analiza shumë-faktorëshe ANOVA në testimin e raportit emocion dhe mënyrës së raportimit	15
Tabela 2. Analiza ANOVA e variablit “emocionet e përjetuara”	28
Tabela 3. Përjetimi i lajmit dhe përcaktimi i shkallës së informimit	28
Tabela 4. ANOVA- Indeksi i integritetit dhe njohurive politike dhe raporti me shkallën e emocionit	28

PËRMBLEDHJE

Modeli eksperimental që prezantohet në këtë studim synon të hulumtojë ndikimin e emocioneve (përfshirë këtu ankthin dhe entuziazmin), në vendimmarrjen e punonjësve të administratës publike në situata me rrezikshmëri ligjore. Duke u bazuar në Teorinë e Inteligjencës Afektive, nëpërmjet këtij eksperimenti synohet të identifikohet (i) se si emocionet ndikojnë në kërkesën për informacione të tjera shtesë para marrjes së një vendimi kur përballemi me një situatë rreziku; si dhe (ii) identifikimin e faktorëve që ndikojnë në sjelljen etike të punonjësve të administratës publike në vendin e punës. Përdorimi i pyetësorëve të para-eksperimentit dhe pas-eksperimentit ndihmoi në testimin e lidhjeve midis faktorëve të tillë si arsimi, origjina, të ardhurat, niveli i njohurive për integritetin, dhe njohuritë politike me sjelljen e vendimmarrjes.

Rezultatet e eksperimentit treguan se punonjësit me njohuri të thella të rregullave të integritetit shfaqin më shumë dëshirë për të marrë informacione kur përballen me shkelje të rregullave në vendin e punës. Analiza e dytë tregoi se faktorë si integriteti, njohuritë politike, mosha, gjinia, studimet universitare jashtë vendit, të ardhurat mujore dhe leximi i librave janë faktorë kyç që ndikojnë në vullnetin e punonjësve për të raportuar shkelje.

Në përfundim, hulumtimi pohon se integriteti profesional është një faktor kyç që ndikon në mënyrën se si trajtohen nga punonjësit e administratës publike në Shqipëri situatat me rrezik. Për të rritur nivelin e integritetit në këto mjedise, rekomandohet organizimi i trajnimeve dhe promovimi i një kulture që i konsideron vlerë integritetin dhe veprimin me etikë. Gjithashtu, duhen marrë parasysh edhe faktorë të tjerë si njohuritë politike, mosha, gjinia, dhe të ardhurat në hartimin e strategjive për të nxitur raportimin e rasteve të shkeljeve në procedurat administrative.

1. PARASHTRIMI DHE KUADRI TEORIK

Për hartimin e eksperimentit u përdor Teoria e Inteligjencës Afektive. Përmes deduksionit, u përcaktuan hapat e eksperimentit të dhënat e të cilit prodhuan informacionin lidhur me faktorët kryesorë që ndikojnë në sjelljen me integritet ose jo të punonjësve të administratës publike.

Modeli eksperimental që u zbatua u bazua në supozimin se emocionet e shkaktuara nga një situatë apo ngjarje shndërrohen në elementë të qenësishëm në marrjen e vendimeve. Kur nëpunësit publikë përjetojnë emocione negative për shkak të informacioneve ose situatave të caktuara, ata priren të izoloohen në ndërveprime me individët që janë jashtë grupit të tyre si dhe të kërkojnë informacione shtesë nga burime që përafrohen më shumë me perspektivat e tyre. Rrjedhimisht, ky model nënkupton që kur zyrtarët publikë e gjejnë veten nën presion ose përballen me situata të vështira në vendin e punës, atyre u duhet më shumë kohë për të marrë informacione shtesë si dhe më shumë kohë për të marrë vendime duke shfaqur sjellje me integritet të lartë. Sipas literaturës së sotme, individëve me nivel më të lartë arsimor dhe me më shumë njohuri për integritetin dhe etikën profesionale zakonisht u duhet më shumë kohë për të mbledhur informacione përpara se të marrin vendime. Prandaj, eksperimenti synoi të testojë nëse **subjektet në gjendje ankthi do të kërkonin më shumë informacione si dhe nëse do të ishin më të gatshëm për të raportuar krahasuar me ata në gjendje entuziazmi apo neutrale**. Për realizimin e qëllimit kryesor, u ndoqën këto hapa:

1. Testimi i lidhjes mes elementëve si arsimi, origjina, të ardhurat, niveli i njohurive për etikën dhe integritetin, etj. me sjelljen e tyre (vendimet që marrin) në vendin e punës. Kjo u realizua nga të dhënat që u mblodhën nga pyetësorët e para-eksperimentit.
2. Nga ana tjetër, pyetësori i pas-trajtimit na ndihmoi të kuptojmë emocionet që përjetojnë zyrtarët publikë (subjektet e eksperimentit) pas ballafaqimit me informacionin e dhënë (nxitësin).
3. Më pas, shqyrtuam se si emocionet e shkaktuara nga nxitësi lidhen me nivelin arsimor, nivelin e njohurive për etikën dhe integritetin në vendin e punës si dhe njohuritë politike.

Në eksperimentin e realizuar u përfshinë gjashtëdhjetë e tre nëpunës të administratës publike dhe u përdor modeli i eksperimentit të pjesshëm në terren me gjurmim dinamik të procesit. Pjesëmarrësit në eksperiment ishin punonjës të institucioneve të ndryshme shtetërore nga Kuvendi i Shqipërisë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Shëndetit Publik.

1.1 TEORIA E INTELIGJENCËS AFEKTIVE

Marcus dhe MacKuen¹ propozuan Teorinë e Inteligjencës Afektive (IA),² e cila sugjeron se emocionet nxisin nevojën për të mësuar dhe përmirësojnë vendimmarrjen. Në hulumtimin e tyre u testua se si emocionet e ndryshme nxisin procesin e vendimmarrjes dhe ndikojnë në të. Sipas tyre, sistemi i temperamentit rregullon emocionin e madh pozitiv, si gëzimin dhe entuziazmin, dhe vepron normalisht,

1 Marcus, G., M. MacKuen, 1993. "Anxiety, Enthusiasm, and the Vote: The Emotional Underpinnings of Learning and Involvement During Presidential Campaigns", *The American Political Science Review*, Vol. 87, Jo. 3 (Sep. 1993), f. 672.

2 Marcus, G. E., et al, 2000. *Affective intelligence and political judgment*. Çikago: University of Chicago Press.

ndërkohë që sistemi i mbikëqyrjes rregullon ankthin dhe alarmon për rreziqe të papritura. Edhe pse entuziazmi përforcon zgjedhjet ekzistuese, ankthi nxit përpunimin intensiv të informacionit, duke përmirësuar kështu cilësinë e vendimmarrjes.

Pavarësisht interesit në rritje të studiuesve mbi Teorinë e Inteligjencës Afektive dhe zbatimin e saj në fusha të ndryshme, janë kryer shumë pak teste eksperimentale për të provuar supozimet e saj. Megjithatë, ekzistojnë të dhëna dhe evidenca që tregojnë se ndjesitë negative (ankthi) rrisin nevojën për informacion^{3/4}. Në kushtet kur ndjesitë shkaktojnë emocione, mënyra se si këto emocione përkthehen në vendimmarrje lidhet edhe me formimin, besimet dhe qëndrimet e individëve⁵. Sipas studiuesve pjesa më e madhe e njerëzve e përpunojnë në mënyrë të njëanshme informacionin, veçanërisht kur marrin informacion të sofistikuar me opinione të forta politike.⁶ Rrjedhimisht, është me rëndësi të përcaktohet shkalla e informacionit politik. I njëjti shpjegim vlen dhe kur matim nivelin e njohjes së rregullave të etikë në vendin e punës.

- 3 Valentino, N., et al, 2008. "Is a Worried Citizen a Good Citizen? Emotions, Political Information Seeking, and Learning via the Internet", *Political Psychology*, Vol. 29, Jo.2.
- 4 Redlawsk, D.P., et al 2007. "Affective Intelligence and Voting: Information processing and learning in a campaign", në Neuman, Marcus, Crigler&MacKuen, *The Affect Effect: Dynamics of Emotions in Political Thinking and Behavior*, Çikago: University of Chicago Press.
- 5 Lodge, M., Taber, C. 2005. "The Automaticity of Affect for Political Leaders, Groups, and Issues: An Experimental Test of the Hot Cognition Hypothesis", *Political Psychology*, Vol. 26, Jo. 3, f. 455.
- 6 Schreiber, D., 2007. "Political Cognition as Social Cognition: Are We All Political Sophisticates?", në *The Affect Effect: Dynamics of Emotions in Political Thinking and Behavior*, edituar nga Neuman, Marcus, Crigler & MacKuen.

2. MODELI EKSPERIMENTAL

Pjesëmarrësit në eksperiment janë 63 punonjës të administratës publike. Ata u ndanë në mënyrë rastësore në dy grupe të barabarta (grupi eksperimental dhe ai i kontrollit) dhe u vendosën në dy salla të ndryshme. Ndarja mes dy grupeve mundësoi krijimin e kushteve eksperimentale të ndryshme për të dy grupet, të cilat u përballën me dy situata ose faktorë eksperimentalë të ndryshëm. Grupi i kontrollit shërben për të vleftësuar krahasimin mes dy grupeve dhe për të evidentuar ndryshimin.

Eksperimenti u zhvillua në tre faza. Përpara nisjes së secilës faze, të dy grupeve iu komunikuan hollësi për fazën dhe hapat që duhet të ndiqnin. Kalimi nga një fazë në tjetrën u shoqërua me 10 minuta pushim, pa të drejtë daljeje nga salla apo komunikimi. Nuk lejohej përdorimi i telefonit ose pyetjet që mund të ndikonin në përqendrimin e pjesëmarrësve. Në fazën e parë u bë plotësimi i të njëjtit pyetësor nga të dy grupet. Në fazën e dytë u përcoll një informacion përmes një videoje për të dy grupet. Përmbajtja e videos ishte e ndryshme për grupin e eksperimentit krahasuar me atë të kontrollit. Faza e tretë kishte në bënte me plotësimin e pyetësorit pas shfaqjes së videos për të dy grupet. Diferenca kryesore mes grupeve ishte skenari i videos dhe informacioni i dhënë në fazën e dytë. Ndërkohë pyetjet e fazës së parë dhe fazës të tretë janë të njëjta për të dy grupet. Të tre fazat e eksperimentit u zhvilluan në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë për të dy grupet.

2.1. FAZA E PARA-EKSPERIMENTIT

Pjesëmarrësit në eksperiment iu përgjigjën tre grupe pyetjesh gjatë seancës së para-eksperimentit. Grupi i parë i pyetjeve kishte informacione të përgjithshme të pjesëmarrësve në studim. Në grupin e dytë të pyetjeve u bë një vlerësim i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me politikën aktuale shqiptare, sistemin politik dhe prioritetet e politikës së jashtme.

2.2 FAZA E EKSPERIMENTIT

Pas plotësimit të pyetësorëve të para-eksperimentit, subjektet u prezantuan me një stimul eksperimental. Gjatë kësaj faze u përdorën skenarët⁷ e trajtimit në formën e "informacionit privat". Çdo material stimulues i prezantuar gjatë eksperimentit u përdor për të evidentuar shenja të ndryshme emocionale: ankth, gëzim dhe gjendje neutrale (asnjë ndjesi) si formë kontrolli.

Në grupin e eksperimentit u përdor një skenar (stimuli), në të cilin përshkruhet një situatë ku një nëpunës i administratës publike përballlet me një kërkesë për të përshpejtuar një kontratë prokurimi që ka probleme në procesin e tenderimit dhe në përmbushjen e kriterëve të kontratës. Nëpunësi zbulon një marrëdhënie të mundshme personale midis eprorit dhe ofertuesit fitues, duke ngritur shqetësime për favorizim dhe integritet. Ky skenar u përdor për të testuar ndikimin e ankthit (frikës) për të kërkuar informacione shtesë. Ndërkohë që në grupin e kontrollit u përdor një skenar, në të cilin përshkruhet një situatë ku një nëpunës i drejtorisë së prokurimeve merr një kërkesë nga eprori për të përshpejtuar një kontratë prokurimi për një projekt madhor dhe konstaton se procesi i tenderimit dhe përzgjedhja e ofertuesit fitues janë kryer në përputhje me rregullat dhe pa favorizime. Ky skenar u përdor për të testuar ndikimin e entuziazmit në dëshirën për të kërkuar informacione shtesë.

7 Skenarët e përdorur janë shkruar për qëllimin e këtij eksperimenti.

Stimuli u prezantua në formën e një videoje ku skenari i hartuar u shfaq me audio (u përdor i njëjti zë në të dy grupet), i shoqëruar me titrat dhe me tekst të printuar. Videoja u shoqërua me një kolonë muzikore neutrale për të dy grupet. (Teksti i përdorur për stimulim gjendet në Shtojcën 2 dhe 4).

Në hulumtimet e neuropsikologjisë, nxitësit vizualë përdoren gjerësisht për të shkaktuar emocione.⁸ Në eksperimentin e zhvilluar, u ndërthurën nxitës nga modalitete të ndryshme –tekst, zë dhe imazhe– që përshkruajnë situata të jetës reale. Në fotot dhe skenarët tregoheshin njerëz në situata të ngjashme me ato të përshkruara në tekst, duke shfaqur shprehje joverbale që tregojnë emocionet e përjetuara.

2.3 FAZA E PAS-TRAJTIMIT

Në seancën e pas-trajtimit, subjekteve të përfshira në eksperiment iu kërkua menjëherë të përshkruanin se si u ndjenë pas dëgjimit dhe leximit të materialit. Në Shtojcën 5 jepen llojet e emocioneve që iu kërkuan: gëzim, krenari, shpresë, zemërim, hidhërim, përbuzje, lodhje, frikë dhe ankth. Më pas, pjesëmarrësve iu kërkua të jepnin informacione lidhur me: (i) sa kohë kanë ndër mend të shpenzojnë gjatë javës së ardhshme për të mbledhur informacionet e nevojshme nga burime të ndryshme lidhur me ngjarjen që dëgjuan; (ii) listën e temave për të cilat do të dëshironin të lexonin më shumë. Numri i temave të listuara, përveç pyetjeve të përmendura më parë, u përdor dhe si matës i përafërt i dëshirës për të kërkuar informacione. Së dyti: Pas ballafaqimit me stimulim, pjesëmarrësit iu përgjigjën një sërë pyetjesh që tregojnë qëndrimet e tyre në lidhje me ngjarjen. Ata kanë bërë një vlerësim për vendimmarrjen, gatishmërisë për të raportuar sjellje të pahijshme dhe perceptimet e kulturës së integritetit të institucionit.

8 Baumgartner, T., et al, 2006. "From Emotion Perception to Emotion Experience: Emotions Evoked by Pictures and Classical Music." International Journal of Psychophysiology 60 (1).

3. METODOLOGJIA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Hulumtimi u mbështet në Teorinë e Inteligjencës Afektive duke supozuar se:

HP1: Individët që përjetojnë **emocione negative** tentojnë të marrin më shumë informacion përpara se të marrin një vendim, duke zbatuar në mënyrë strikte rregullat e integritetit.

HP2: Individët që përjetojnë **emocione pozitive** marrin vendime më lehtë dhe nuk thellohen në informacion duke qenë më të prirur për të mos ndjekur rregullat e integritetit.

Në këtë studim, janë përdorur analizat ANOVA për të vlerësuar ndikimin e emocioneve në nivelin e informacionit dhe reagimin ndaj procedurave të prokurimit.

Fillimisht, është analizuar nëse ekzistojnë dallime statistike të rëndësishme në emocionet e krijuara mes grupit të eksperimentit dhe grupit të kontrollit pas ballafaqimit me stimulimin, për të vlerësuar ndikimin e emocioneve në reagimet ndaj informacionit të marrë. Më pas, është analizuar lidhja mes emocioneve të krijuara dhe nivelit të kërkesës për informacion, duke testuar hipotezat se emocionet negative çojnë në kërkimin e më shumë informacioneve, ndërsa emocionet pozitive ndikojnë në marrjen e vendimeve më të shpejta dhe më pak të detajuara. Së fundmi, është analizuar se si ndikojnë emocionet e krijuara në gatishmërinë për të reaguar ndaj situatave të perceptuara me risk të lartë për korrupsion, duke shqyrtuar edhe ndikimin e njohurive politike, ndërgjegjësimit për etikën dhe faktorëve të tjerë.

3.1. ANALIZA E DIFERENCËS NË EMOCIONET E KRIJUARA PAS STIMULIT NË GRUPIN EKSPERIMENTAL DHE TË KONTROLLIT (ANOVA)

Fillimisht, u testua nëse ka diferencë mes grupit të eksperimentit dhe atij të kontrollit në lidhje me emocionet e krijuara pas ballafaqimit me stimulimin (videon). Variabli i analizuar është: 'emocione të krijuara'⁹ pas ballafaqimit me stimulimin. Për të analizuar 'emocionet e krijuara', alternativat e përgjigjeve për të dy grupet u kodifikuan si më poshtë:

Emocion negativ: shpeshtësia e përgjigjeve 'aspak' dhe 'jo shumë'

Neutral: shpeshtësia e përgjigjeve 'disi'

Emocion pozitiv: shpeshtësia e përgjigjeve: 'shumë'

9 Krijimi i variablit 'emocione të krijuara': është përdorur pyetja në Shtojcën C: A do të thoshit se informacioni në lidhje me procedurën e prokurimit dhe vendimin e marrë nga eprori juaj ju bën të ndiheni:

I shqetësuar, i frikësuar, në ankth, i zemëruar, i neveritur, i hidhur, entuziast, krenar, plot shpresë


Aspak (...) 2) Jo shumë (...) 3) disi (...) 4) Shumë (...) 5) Nuk e di/i(e) pasigurt

* Tre pikat e para përdoren për të funksionalizuar gjendjen e ankthit, grupi i dytë për zemërimin dhe grupi i fundit do të përfaqësojë entuziazmin. Pra, "emocionet e krijuara" ka ardhur si rezultat i analizës së diferencës së "emocioneve të krijuara" mes dy grupeve pas stimulit.

Krahasimi i 'emocione të krijuara' për të dy grupet u realizua përmes analizës ANOVA (me një drejtim). Rezultatet e testit ANOVA) **dëshmojnë se ka një dallim statistikisht të rëndësishëm midis grupeve të analizuara** (testi statistikor F -statistic = 8.683 (niveli i rëndësisë: 0.005). Kjo do të thotë se faktori 'emocion' është i ndikueshëm nga stimuli, transmetimi i videos (Shtojca 6, Tabela 2). Ky rezultat mbështetet edhe nga të dhënat e grafikut 1, në të cilin jepen përgjigjet e pjesëmarrësve (për të dy grupet) pasi janë pyetur mbi ndjesitë e krijuara pas shfaqjes së videos.

Sipas të dhënave në grafik, individët në grupin e eksperimentit raportojnë të kenë ndjerë më shumë emocione negative krahasuar me grupin e kontrollit. Në grupin eksperimental, 31% e pjesëmarrësve pohuan se videoja u shkaktoi emocione negative, që është afërsisht dy herë më shumë se në grupin e kontrollit, ku vetëm 16.7% raportuan emocione të tilla. Ndërkohë, për 'emocione pozitive', në grupin i kontrollit, 56.6% e pjesëmarrësve pohuan se videoja u shkaktoi emocione pozitive, një shpërndarje gati 3 herë më të lartë se grupi eksperimental, ku vetëm 13.8% e tyre raportuan emocione të tilla.

Figura 1. Si ju bën të ndjeheni informacioni për procedurën e prokurimit?



3.2. ANALIZA E LIDHJES MES EMOCIONEVE TË KRIJUARA DHE NIVELIT TË INFORMACIONIT MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT


Analiza e 'lidhjes mes emocioneve dhe nivelit të informacionit' fokusohet te lidhja midis emocioneve dhe nivelit të informacionit të kërkuar përpara marrjes së vendimit, duke testuar hipotezat se emocionet negative çojnë në kërkimin e më shumë informacioneve, ndërsa emocionet pozitive ndikojnë në marrjen e vendimeve më të shpejta dhe më pak të detajuara.

Për testimin e këtyre hipotezave është përdorur analiza ANOVA.¹⁰ Sipas rezultateve të ANOVA-s, tregohet se ka një lidhje, statistikisht të rëndësishëm, mes emocioneve që formohen dhe nivelit të informacionit që nëpunësit kanë kërkuar për një procedurë prokurimi të diskutuar. Besueshmëria e modelit (F= 61,918***, vlera p. =0.000) konfirmon se mes dy grupeve të studiuara ka një ndryshim në sjellje, në shkallën e informimit mbi procedurën e tenderimit.

10 ANOVA (Analysis of Variance) – analiza e variancës

Grupi i eksperimentit dhe grupi i kontrollit, në rastin kur krijojnë emocione pozitive, kanë pothuajse të njëjtën shkallë informimi dhe kjo shkallë është e ulët (1.3 - informim i ulët, shih grafikun 2). Kur grupet deklarojnë se nuk iu ka bërë ndonjë përshtypje materiali video që panë (pra emocione neutrale), grupi i kontrollit vazhdon të ketë shkallë informimi të ulët, ndërkohë individët që u përballën me stimulën dhe deklaruan se nuk u bëri përshtypje (nuk u krijoi ndjenja pasigurie, ankthi apo shqetësimi), në fakt manifestojnë shkallën më të lartë të informimit (mesatarisht 1.75). Ky fakt shpjegohet deri diku me mungesën e sinqeritetit në përgjigjen mbi emocionet që përjetuan ata. Individët kanë tentuar të mos e shprehin shqetësimin që u krijon një lajm për një procedurë prokurimi me risk për të krijuar praktikë korruptive, duke deklaruar se nuk e dinë ose nuk kanë ndonjë shkallë shqetësimi (pra neutralitet), ndërkohë që kanë intensifikuar përpjekjet për t'u informuar. Përpjekjet për t'u informuar mbi procedurën e tenderimit për të cilën kanë shprehur se ndiejnë shqetësim nga lajmet që kanë qarkulluar janë rritur për të dy grupet, si për ata të kontrollit ashtu edhe për grupin eksperimental. ***Kjo mënyrë sjelljeje tregon se janë pasiguria dhe risku i perceptuar ata që nxisin reagim edhe më të fortë se një situatë e konfirmuar problematike.***

Figura 2. Dallimi mes grupeve në raportin mes shkallës së emocioneve dhe nevojës për informacion



Këtij specifikimi të modelit i mungojnë edhe faktorë të tjerë të rëndësishëm në përcaktimin e shkallës së informimit, si p.sh., ato demografikë/socialë, politikë apo dhe aspekte të ndërgjegjësimit të individëve mbi integritetin dhe etikën. Për këtë arsye, analiza është thelluar më tej duke përfshirë dhe variabla të tjerë, të shpjeguar sipas Modelit 2 dhe 3 të analizës ANOVA.

3.2.1. ANALIZA E LIDHJES MES NIVELIT TË INFORMACIONIT ME NJOHURITË POLITIKE DHE NJOHURISË MBI INTEGRITETIN DHE ETIKËN

Modeli i dytë (modeli i përzier univariate ANOVA) përfshin në analizë variablin e 'njohurive' apo përfshirjes së individëve me çështje të politikës dhe është ndërtuar duke përdorur pyetjet e pyetësorit

(pyetjet 14-27¹¹). Variabli mbi njohuritë dhe ndërgjegjësimin e punonjësve për integritetin dhe etikën është gjeneruar si treguesi i njohurive mbi integritetin (pyetja 29). Përmes këtij modeli, *testojmë lidhjen mes emocioneve të krijuara nga stimuli i eksperimentit, ndërkohë që marrim në konsideratë faktin se shkalla e informimit dhe emocionet e krijuara ndikohen nga njohuritë politike dhe ndërgjegjësimi për etikën dhe integritetin.*

Rezultatet e analizës sipas *modelit të dytë ANOVA theksojnë edhe një herë se niveli i informacionit të kërkuar përcaktohet nga emocionet, por këtë herë duke përfshirë në analizë edhe njohuritë politike.* Sipas të dhënave, duket se shkalla e njohjes dhe përfshirjes në politikë është një faktor i rëndësishëm statistikor në shpjegimin e emocioneve dhe shkallës së informimit, ndërkohë që ndërgjegjësimi dhe njohja e konceptit të integritetit dhe etikës kanë ndikim më të ulët në shkallën e informimit (shih tabelën 2, Shtojca 6). Kjo do të thotë se punonjësit e administratës publike që kanë njohuri politike janë më të prirur të kërkojnë informacion të shtuar përpara se të marrin një vendim kur janë përballë rasteve me rrezik.

3.2.2. ANALIZA E LIDHJES MES NIVELIT TË INFORMACIONIT ME NJOHURITË POLITIKE DHE TIPARET DEMOGRAFIKE


Për të kuptuar më mirë faktorët kryesorë që ndikojnë në sjelljen e nëpunësve të administratës publike kur përballen me situata të perceptuara si të rrezikshme, në analizën tonë (në modelin e tretë, ANOVA efekti i përzier) kemi përfshirë edhe variabla demografikë si shpjegues të emocioneve të krijuara dhe shkallës së informimit. Ky model (modeli i përzier, univariate ANOVA) është zgjeruar duke përfshirë variabla që profilizojnë individët bazuar në tiparet e tyre demografike dhe sociale, duke u nisur nga hipoteza se faktorët demografikë dhe socialë ndikojnë në sjelljen e individit dhe raportin e tij me informacionin. Variablat e përfshira në këtë model përfshijnë *moshën, gjininë, nivelin arsimor, faktin nëse individi ka përfunduar studime të larta jashtë vendit, si dhe nivelin e të ardhurave.*

Rezultatet nga modeli i tretë na ndihmojnë të kuptojmë ndryshimet në sjelljen e individëve mes dy grupeve për shkak të stimulit ndaj të cilit janë ekspozuar. Ashtu si në modelin e dytë, faktori politik konfirmohet si një faktor përcaktues për nivelin e emocioneve dhe të informacionit. Faktorë të tjerë të rëndësishëm që ndikojnë në këto aspekte janë moshë, gjinia, niveli arsimor, studimet jashtë vendit, dhe niveli i të ardhurave. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ky studim nuk kishte për qëllim të analizonte ndikimin e këtyre faktorëve në nevojën për informacione, por vetëm t'i identifikonte ato. Për të kuptuar më mirë lidhjen dhe ndikimin e gjinisë, moshës, arsimimit dhe nivelit të të ardhurave në kërkesën për informacione, duhet të ndërmerren studime të tjera të thelluara.

Analiza e lidhjes mes emocioneve të krijuara nga përballja me lajmin për një rast prokurimi korruptiv duke përfshirë edhe variablat ndihmës evidenton ndryshimin mes grupit të kontrollit dhe grupit të eksperimentit. ***Paraqitja grafike (figura 3) sugjeron se shkalla e informimit të grupit të eksperimentit mbetet në çdo rrethanë më e lartë se ajo të grupit të kontrollit.***

11 Pyetjet 14 deri në 27 kanë informacion për çështjet politike. Pjesëmarrësve në studim u është kërkuar të identifikojnë përgjigjen e saktë nga disa alternativa. Personat që japin përgjigje të saktë kanë njohuri dhe përfshirje me çështje të politikës së nivelit të lartë. Përgjigjet e sakta janë mbledhur duke krijuar kështu treguesin e njohurive politike.

Figura 3. Shkalla e ndikimit të emocioneve në informimin mbi një procedurë prokurimi



Ndërkohë të ekspozuar përballë një stimuli, të dy grupet ndryshojnë sjelljen në mënyra të ndryshme. Grupi i kontrollit ka një shkallë informimi mesatare (mesatarja 1.5 nga 3), nëse përjeton ndjenjë shqetësimi për procedurën e prokurimit. Kjo shkallë informimi nënkupton që individi do të tentojë të lexojë/akumulojë lajme dhe informacione që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen. Nëse stimuli nuk i krijon asnjë emocion (shkallë neutrale), individi ul ndjeshëm shkallën e informimit (mesatarja 1.2 nga 3) dhe nëse ka emocione pozitive (pavarësisht lajmeve nuk ndien shqetësim) shkalla e informimit shkon në nivelin më të ulët.

Ndryshe paraqitet reagimi i individëve që bëjnë pjesë në grupin e eksperimentit. Ata shfaqin një shkallë të lartë informimi nëse ndiejnë shqetësim apo emocione negative nga stimuli. Këtu identifikohet se shkalla e informimit është mesatarisht 1.6 nga 3, ndërkohë përballë emocioneve neutrale raportohet një shkalla më e lartë e informimit (1.8 nga 3, shih figurën 3). ***Ky fakt konfirmon edhe njëherë se vigjilanca dhe reagimi nga punonjësit e administratës publike janë më të larta kur situata paraqitet e paqartë dhe mbart pasiguri, të cilat punonjësit duket të mos kenë dëshirë t'i pohojnë, por kanë kujdes dhe përfshihen përpjekje intensive për t'u informuar.***

3.3. ANALIZA E LIDHJES MES EMOCIONEVE TË KRIJUARA ME REAGIMIN

Shkalla e informimit mbi një procedurë prokurimi që shfaqet se mbart rrezik është një prej mënyrave të reagimit të punonjësit e administratës publike. Mënyrë tjetër reagimi do të ishin veprimet e ndërmarra. Për të kuptuar se si lidhet risku i perceptuar për akte korruptive me veprimet e punonjësve të administratës publike, ne analizuam prevalencën e një punonjësi publik për të raportuar raste me risk të lartë korrupsioni si funksion i emocioneve të krijuara dhe faktorëve shpjegues, si njohuritë politike, njohja dhe ndërgjegjësimi për integritetin dhe etikën si dhe një sërë faktorësh demografikë socialë.

Analiza ndjek një metodologji të njëjtë si më parë. Fillimisht, analizojmë si ndikojnë emocionet e krijuara të prirja për të raportuar e më pas zgjerojmë modelin duke përfshirë shkallën e njohurive politike dhe integritetin si faktorë si dhe karakteristikat demografike dhe sociale si variabla shpjeguese të prevalencës për të raportuar. Sipas rezultateve të analizës (shih tabelën 1) duket se ka një

ndryshueshmëri statistikisht të besueshme të prevalencës për të raportuar për grupin e përfshirë në eksperiment (F-statistic për modelin, 94.8, -value = 000). *Prirja për të raportuar është e ndikuar dhe e ndërlidhur me faktorët e identifikuar në mënyrë më të fortë sesa prirja për t'u informuar.*


Nga rezultatet duket se raportimi tek eprorët është më pak emocional dhe më shumë i ndikuar nga përfshirja/ njohja me çështjet politike si dhe nga njohuritë mbi integritetin dhe etikën (koeficientët e influencës janë më të lartë për integritetin (0.43) dhe njohjen e politikës (0.55) kundrejt koeficientit të influencës së emocioneve (0.19). Ndryshueshmëria e emocioneve sipas grupeve të eksperimentit është faktori që influencon prevalencën për të raportuar më shumë sesa vetë emocionet. Ndër faktorët demografikë dhe social që ndikojnë tendencën e punonjësve për të raportuar janë gjinia, shkollimi jashtë vendit dhe niveli i të ardhurave personale.

Tabela 1. Analiza shumë-faktorëshe ANOVA në testimin e raportit emocion dhe mënyrës së raportimit

Variabli i ndërvuarur: Raportimi						
	Shuma e Katrorëve	df	Mesatarja e Katrorëve	F - Statistikë	P- Vlera	Koeficienti i influencës (ETA e pjeshme katrore)
Model	254.310	14	18.165	94.480	.000	.971***
Emocionet (faktor)	.592	2	.296	2.977	.069	.186**
Integriteti (faktor rastësor)	1.924	8	.240	2.417	.042	.426**
Njohuritë Politike (faktor rastësor)	3.144	8	.393	3.949	.004	.549**
Variablat e përbashkët						
Mosha	.150	1	.150	1.505	.231	.055
Gjinia	1.402	1	1.402	14.088	.001	.351**
Niveli i Arsimit	.185	1	.185	1.860	.184	.067
Shkollim jashtë vendit (i lartë)	.460	1	.460	4.621	.041	.151**
Niveli i të ardhurave	.798	1	.798	8.019	.009	.236***
Numri i librave të lexuar (2023)	.145	1	.145	1.460	.238	.053
Emocionet*Grupet	1.131	3	.377	3.789	.022	.304**
Gabimi	7.690	40	.192			
Total	262.000	54				
R katror = .971 (R katror i përshtatur = .960)						

Të dhënat në Figurën 4 tregojnë se tendenca për të raportuar është sistematikisht më e lartë për grupin e eksperimentit kundrejt grupit të kontrollit. *Një fakt tjetër që vihet re është fakti që punonjësit kanë deklaruar se zgjedhin të raportojnë problematikat tek eprori dhe të procedojnë, ose të procedojnë duke mos raportuar tek eprori por duke ndjekur ligjshmërinë në përgatitjen e dokumentacionit. Të heshtësh nuk duket të jetë një zgjedhje, pasi asnjë nga grupet nuk raporton një tendencë për të heshtur (kategoria 1). Nëse emocionet që përjetojnë janë pozitive të dy grupet manifestojnë të njëjtën prevalencë të raportimit, punonjësit zgjedhin të mos raportojnë por të plotësojnë procedurën duke ndjekur rregullat dhe respektuar ligjshmërinë (mesatarja 2.1, shih Figurën 3).*

Figura 4. Prevalenca e raportimit¹²



Sipas të dhënave të paraqitura në analizë, duket se faktorë si integriteti, njohuritë politike, mosha, gjinia, studimet universitare jashtë vendit, të ardhurat mujore dhe leximi i librave, kanë një ndikim të rëndësishëm në nxitjen e raportimeve për shkeljet e rregullave në procedurat e prokurimit nga punonjësit e administratës publike. Këto të dhëna sugjerojnë se punonjësit me njohuri politike priren të raportojnë më shumë raste të shkeljeve krahasuar me ata që kanë njohuri më të kufizuara. Po ashtu, mosha dhe gjinia e punonjësve ndikon në vullnetin e tyre për të raportuar raste të shkeljeve, ndaj diskutimet se si mund të trajtohen këta faktorë për të nxitur raportimin e rasteve me shkelje mund të jetë një vlerë e shtuar në debatin publik. Nga ana tjetër, të dhënat sugjerojnë se të ardhurat mujore dhe leximi i librave ndikon në përgjegjësinë e punonjësve për të raportuar raste të shkeljeve, ndaj ka interes të analizohen se si mund të përdoren këto faktorë për të përmirësuar këtë ndërgjegjësim. Rekomandohet të bëhet një diskutim që fokusohet te këta faktorë specifikë me qëllim hartimin e strategjive efikase për të nxitur raportimin e rasteve të shkeljeve nga punonjësit e administratës publike.

12 Prevalenca e raportimit është krijuar duke klasifikuar përgjigjet e pyetjes 4/Shtojca 3. Përgjigjet sipas kategorisë së parë dhe të tretë janë klasifikuar si tendencë për të proceduar duke ndjekur procedurën pa raportuar (kategoria 2). Përgjigjet sipas kategorisë 2 janë klasifikuar si tendencë për raportim (kategoria 3) dhe përgjigja sipas opsionit 4 është klasifikuar si tendencë për të heshtur (kategoria 1).

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë eksperiment u testua:

1. Roli i stimulit - si kanë ndikuar emocionet e krijuara nga stimuli në eksperiment **në rezultatet e analizës duke vërtetuar se këto rezultate nuk janë të rastësishme**. Përmes analizës dhe të dhënave të përfutuara prej saj, ky pohim u vërtetua.
2. Nevoja për informim përpara marrjes së vendimeve në situata me rrezik si dhe faktorët që ndikojnë në kërkesën për më shumë informim.
3. Lidhja mes emocioneve të krijuara nga një situatë me rrezik dhe gatishmërisë për të raportuar rastin.

Pas analizës dhe përpunimit të të dhënave, eksperimenti social për rregullat strikte dhe të buta të integritetit solli në vëmendje disa konstatime interesante. Punonjësit e administratës publike që shfaqën njohje të rregullave të integritetit dhe etikës në vendin e punës treguan nivel më të lartë të përgjegjësisë dhe përputhshmërisë me këto rregulla. Ata shfaqën interes për zbatimin e tyre dhe kërkuan më shumë informacion për të marrë vendime në situata me rrezik, sikurse ajo e prezantuar përmes stimulit të eksperimentit. Ky konstatim gjen zbatim për të dy grupet që morën pjesë në këtë eksperiment, si për grupin që u ballafaqua me parregullsi në procedurën e prokurimit ashtu dhe në grupin të cilit iu prezantua procedura e rregullt. Pra, sa më i lartë është nivel i integritetit, aq më e lartë është dëshira për të marrë informacione në rast shkeljeje të rregullave në vendin e punës. Kjo pohon se **integriteti është faktori kryesor që ndikon në mënyrën se si trajtohen situatat me rrezik në institucionet publike**.

Bazuar në të dhënat dhe përfundimet e analizës, për të rritur integritetin në institucionet e administratës, mund të merren parasysh disa hapa:

1. Organizimi i trajnimeve për të ndërgjegjësuar punonjësit lidhur me rëndësinë e integritetit në vendin e punës. Në këto trajnime mund të përfshihen raste studimore, diskutime në nivel grupi si dhe prezantime me situata të ndryshme rreziku për të ndihmuar punonjësit të kuptojnë rëndësinë e veprimeve etike.
2. Promovimi i një kulturë ku integriteti dhe veprimi me etikë janë vlera themelore. Kjo mund të bëhet duke përfshirë integritetin në politikat dhe procedurat e institucionit si dhe duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie në të gjitha veprimet.

Megjithatë, krahas faktit se integriteti ndikon në kërkesën për më shumë informacion në rast situatë me rrezik, eksperimenti prodhoi të dhëna të tjera interesante ku u identifikuan ata faktorë kyç që ndikojnë në raportim. Pra, teksa niveli i integritetit rrit ndjeshëm ndjenjën e përgjegjësisë, janë disa faktorë të tjerë, të cilët e bëjnë një punonjës të administratës publike të ndërmarrë hapa për të raportuar ngjarjen. Sipas të dhënave të paraqitura, faktorë si integriteti, njohuritë politike, moshja, gjinia, studimet universitare jashtë vendit, të ardhurat mujore dhe leximi i librave kanë një ndikim të rëndësishëm në raportimin e rasteve të shkeljeve në procedurat e prokurimit nga punonjësit e administratës publike. Këto të dhëna konfirmojnë se për të nxitur punonjësit e administratës publike të raportojnë rastet e shkeljeve është e rëndësishme të marrin parasysh këta faktorë në hartimin e strategjive për të rritur ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë e tyre. Duke marrë parasysh këto faktorë, sugjerohet të fillohet me diskutime ku të trajtohet përdorimi i këtyre faktorëve për të nxitur punonjësit e administratës publike të denoncojnë raste të shkeljeve.

REFERENCAT

- Baumgartner, Thomas, Michaela Esslen, and Lutz Jäncke. 2006. "From Emotion Perception to Emotion Experience: Emotions Evoked by Pictures and Classical Music." *International Journal of Psychophysiology* 60 (1): 34-43.
- Ekman, Paul, "Emotion in the Human Face", Cambridge University Press, 1982.
- Groenendyk, Eric, "Current Emotion Research in Political Science: How Emotions Help Democracy Overcome its Collective Action Problem", *Emotions Review*, 2011, f. 453-463.
- Lang, P.J., Bradley, M., and Cuthbert, B., International Affective Picture System, Gainesville, Florida, Center for Research in Psychophysiology, 1995., in Baumgartner, Thomas, Michaela Esslen, and Lutz Jäncke. 2006. "From Emotion Perception to Emotion Experience: Emotions Evoked by Pictures and Classical Music." *International Journal of Psychophysiology* 60 (1): 34-43.
- Lodge, M., Taber, C. 'The Automaticity of Affect for Political Leaders, Groups, and Issues: An Experimental Test of the Hot Cognition Hypothesis', *Political Psychology*, Vol. 26, Jo. 3, 2005, f. 455-482.
- Marcus, G., MacKuen, M., "Anxiety, Enthusiasm, and the Vote: The Emotional Underpinnings of Learning and Involvement During Presidential Campaigns", *The American Political Science Review*, Vol. 87, Jo. 3 (Sep. 1993), f. 672-685.
- Marcus, George E., W. Russell Neuman, and Michael Mackuen., "Affective intelligence and political judgment." Chicago: University of Chicago Press, (2000).
- Redlawsk, D.P., Civettini, A.J., & Lau, R.R., "Affective Intelligence and Voting: Information processing and learning in a campaign", in Neuman, Marcus, Crigler & MacKuen, "The Affect Effect: Dynamics of Emotions in Political Thinking and Behavior", 2007., f. 152-179, Chicago, IL, University of Chicago Press.
- Redlawsk, David "Feeling Politics: New Research Into Emotions and Politics", in 'Feeling Politics: Emotions in Political Information Processing', edited by David P. Redlawsk, Pegrave MacMillan, 2006.
- Schreiber, Darren, "Political Cognition as Social Cognition: Are We All Political Sophisticates?", in *The Affect Effect: Dynamics of Emotions in Political Thinking and Behavior*, edited by Neuman, Marcus, Crigler & MacKuen, 2007, f. 48-71.
- Valentino, N., Hutchings, V., Banks, A., Davis, A., "Is a Worried Citizen a Good Citizen? Emotions, Political Information Seeking, and Learning via the Internet", *Political Psychology*, Vol. 29, Jo.2, 2008.

SHTOJCA I – PYETËSORI PARA-EKSPERIMENT

1. Cila është vendlindja juaj?

2. Çfarë moshe keni?

3. Cila është gjinia juaj?

1 Mashkull

2 Femër

3 Tjetër (lutemi përcaktojeni) _____

4. Çfarë niveli arsimor keni përfunduar?

1 Të mesëm

2 Universitar

3 Master

4 Doktoraturë

5 Post-doktoraturë

5. A i keni ndjekur studimet universitare në Shqipëri?

1 Po 2 Jo

6. A i keni ndjekur studimet universitare jashtë vendit?

1 Po 2 Jo

7. Nëse po, ku i keni ndjekur studimet universitare?

8. A keni jetuar jashtë vendit më parë?

1 Po 2 Jo

9. Nëse po, çfarë pune keni bërë kur jetonit jashtë vendit?

10. Sa janë të ardhurat tuaja mujore individuale (neto)?

- 1 Më pak se 70,000 lek
2 70,001 deri në 90,000 lek
3 90,001 deri në 110,000 lek
4 Mbi 110,001 lek

11. Sa janë të ardhurat tuaja mujore familjare (neto)?

- 1 Më pak se 70,000 lek
2 70,001 deri në 120,000 lek
3 120,001 deri në 170,000 lek
4 Mbi 170,001 lek

12. Sa herë në vit udhëtoni jashtë shtetit?

13. Sa herë në vit bëni pushime?

14. A lexoni zakonisht libra?

- 1 Po 2 Jo

15. Sa libra keni lexuar në vitin 2023?

16. Çfarë funksioni politik mban Arben Ahmetaj?

17. Çfarë shumice kërkohet në Kuvend për ndryshimin e Kushtetutës?

- 1 Shumica e thjeshtë
2 Shumica e cilësuar

- 3 Referendum
- 4 Procedura e veçantë
- 5 Të gjitha

18. A ka të drejtë vetoje Presidenti i Shqipërisë mbi vendimet e Kuvendit?

- 1 Po
- 2 Jo
- 3 Nuk e di

19. Sa deputetë ka Kuvendi i Shqipërisë?

20. Cili sistem zgjedhor është në fuqi dhe zbatohet për zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit?

- 1 Proporcional me lista të mbyllura
- 2 Sistemi i kombinuar për zgjedhjet në një raund
- 3 Proporcional rajonal
- 4 Asnjë prej opsioneve

21. Kush është Guvernatori i Bankës së Shqipërisë?

- 1 Elvira Sejko
- 2 Luljeta Minxhozi
- 3 Ardian Fullani
- 4 Gent Sejko
- 5 Nuk e di

22. I rrumbullakosur në numrin më të afërt, sa ka qenë buxheti vjetor i Shqipërisë në 4 vitet e fundit?

- 1 5.3 miliardë euro
- 2 4.5 miliardë euro
- 3 5.6 miliardë euro
- 4 4.8 miliardë euro
- 5 Nuk e di

23. Shkalla e papunësisë në Shqipëri është afërsisht e barabartë me?

- 1 11.9 %
- 2 12.3%
- 3 10.2%
- 4 13.00%
- 5 Nuk e di

24. Kush është aktualisht Ministri i Mbrojtjes në Shqipëri?

- 1 Niko Peleshi
- 2 Arta Dade
- 3 Taulant Balla
- 4 Fatmir Xhafa
- 5 Nuk e di

25. A është Shqipëria anëtare e Këshillit të Evropës?

- 1 Po
- 2 Jo
- 3 Nuk e di

26. Sa anëtarë ka Bashkimi Evropian?

- 1 28
- 2 27
- 3 29
- 4 26
- 5 Nuk e di

27. Në cilin vit e fitoi Shqipëria statusin e vendit kandidat të Bashkimit Evropian?

- 1 2013
- 2 2014
- 3 2015
- 4 2016
- 5 2017
- 6 Nuk e di

28. Lutemi të përgjigjeni me “Po” ose “Jo” duke qarkuar përgjigjen “Po” ose “Jo” për secilën pyetje.

a	A ka institucioni juaj Kod të Sjelljes ose Kod të Etikës?	Po	Jo
b	A keni marrë pjesë në trajnime për kodin e etikës dhe integritetit të institucionit tuaj?	Po	Jo
c	A keni kërkuar ndonjëherë udhëzime ose sqarime për çështje etike nga drejtoria e burimeve njerëzore në institucionin tuaj?	Po	Jo
ç	A jeni në dijeni të procedurave për raportimin e shkeljeve të etikës ose të sjelljes së keqe në vendin tuaj të punës?	Po	Jo
d	A i keni lexuar ndonjëherë politikat e institucionit tuaj për konfliktin e interesit?	Po	Jo
dh	A jeni njohur me pasojat e shkeljes së etikës dhe integritetit të institucionit tuaj?	Po	Jo
e	A i dini procedurat për trajtimin e informacionit dhe të dhënave konfidenciale në vendin tuaj të punës?	Po	Jo
ë	A jeni në dijeni të udhëzimeve për pranimin e dhuratave, favoreve ose ryshfeteve nga aktorë të jashtëm në institucionin tuaj?	Po	Jo
f	A keni marrë udhëzime se si t'i trajtoni situatat ku interesat tuaja personale mund të bien ndesh me detyrën tuaj profesionale?	Po	Jo
g	A i njihni procedurat për raportimin e shkeljeve të etikës dhe integritetit në institucionin tuaj?	Po	Jo

SHTOJCA II. SKENARI A PËR GRUPIN E EKSPERIMENTIT. PROCESI JO-ETIK I PROKURIMIT (NXITËSI I ANKTHIT)

Jeni një nëpunës i përkushtuar që punon në administratën publike. Drejtorja juaj është përgjegjëse për të garantuar që të gjitha proceset e prokurimit të kryhen me integritetin maksimal dhe në respekt të plotë të legjislacionit në fuqi. Një ditë, ju vjen një email nga eprori juaj, i cili është autoriteti për të miratuar të gjitha vendimet e prokurimit. Në email bëhet një kërkesë për të përshpejtuar një kontratë prokurimi për një projekt madhor. Eprori ju informon se kjo kontratë është me shumë leverdi për institucionin dhe ka presione të mëdha që vijnë nga eprorët në nivele më të larta për ta mbyllur sa më shpejt si procedurë. Megjithatë, teksa shqyrtoni me kujdes dokumentet e prokurimit dhe kriteret e vlerësimit, vini re disa probleme të dukshme:

1. Ofertuesi fitues, Shoqëria A, nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për kontratën.
2. Procesi i tenderimit nuk ishte i hapur dhe konkurrues siç kërkohet me rregullore. U mor vetëm një propozim që ishte ai i dërguar nga Shoqëria A.
3. Duket se eprori juaj ka një marrëdhënie personale me pronarin e Shoqërisë A, gjë që ngre shqetësime për favorizim të kësaj të fundit.
4. Kushtet e propozuara të kontratës janë dukshëm më të favorshme për Shoqërinë A nga sa duhet të jenë, duke i kushtuar potencialisht administratës publike një shumë të konsiderueshme parash.

Menjëherë pas shfaqjes së stimulit në një monitor të madh, subjektet në eksperiment iu përgjigjën menjëherë disa pyetjeve.

Çfarë qëndrimi do të mbani? (Po/Jo) (Shtojca C)

1. Mund të vendosni të ndiqni procedurat e përcaktuara të prokurimit, sipas të cilave do të duhet të refuzohet propozimi i bërë nga Shoqëria A për shkak të parregullsive të shumta.
2. Mund të informoni eprorin për shqetësimet tuaja lidhur me procesin e prokurimit dhe të kërkoni që ky proces të kryhet në mënyrë të drejtë dhe transparente, në përputhje me ligjet.
3. Mund të vazhdoni me procesin e përshpejtuar të prokurimit siç ju ka udhëzuar eprori, duke i anashkaluar parregullsitë dhe problemet. Në fund të fundit, firma do të jetë ajo e eprorit, kështu që ju nuk keni përgjegjësi.
4. Mund të vendosni të mos flisni për problemet që keni identifikuar në mënyrë që të shmangni përplasjet me eprorin tuaj.

Çdo pyetje e mësipërme ka një përgjigje si më poshtë: (Kjo pjesë nuk u nda me të anketuarit.)

Opsioni 1: Respektoni integritetin dhe ndiqni procedurat.

Opsioni 2: Informoni eprorin për shqetësimet.

Opsioni 3: Komprometoni integritetin dhe vazhdoni me procedurat sipas udhëzimit të eprorit.

Opsioni 4: Nuk flisni për parregullsitë.

Ky skenar paraqet një dilemë të ndërlikuar etike ku nëpunësit publikë duhet të bënin zgjedhje që pasqyrojnë integritetin dhe angazhimin e tyre për të respektuar standardet etike në një proces prokurimi. Përgjigjet ndaj këtyre opsioneve kanë treguar nivelin e integritetit dhe vendimmarrjes etike të pjesëmarrësve.

SHTOJCA III. PYETËSORI POST-EKSPERIMENT PËR GRUPIN E EKSPERIMENTIT

1. Si ju bën të ndjeheni informacioni për procedurën e prokurimit? Sa i shqetësuar, i frikësuar, në ankth, i zemëruar, apo i neveritur, ose i hidhëruar ndjeheni?

- 1 Aspak
- 2 Jo shumë
- 3 Disi
- 4 Shumë
- 5 Nuk e di/ i(e) pasigurt

2. Nëse kjo situatë bëhet publike, sa kohë keni ndërmend të shpenzoni në javën e ardhshme për të marrë informacione më të hollësishme lidhur me këtë çështje? (p.sh. kohë për leximin e gazetave, ndjekjen e TV-së, përdorimin e internetit, studim i mëtejshëm i kuadrit ligjor).

- 1 Do të dëgjoj çdo ditë lajmet që lidhen me këtë çështje
- 2 Nëse dëgjoj lajme rastësisht do të ishte mirë
- 3 Neutral
- 4 Kam shumë pak interes në lidhje me këtë çështje
- 5 Nuk kam fare interes

3. Ju lutemi renditni disa çështje të administratës publike që ju shqetësojnë, e për të cilat mendoni se duhen diskutuar në media.

4. Çfarë qëndrimi do të mbani në lidhje me procedurën që patë në video?

- 1 Do të ndjek procedurat e përcaktuara të prokurimit, sipas të cilave do të më duhet të refuzoj propozimin e bërë nga Shoqëria A për shkak të parregullsive të shumta.
- 2 Do të informoj eprorin për shqetësimet e mia lidhur me procesin e prokurimit dhe do të kërkoj që ky proces të kryhet në mënyrë të drejtë dhe transparente, në përputhje me ligjet në fuqi.
- 3 Do të vazhdoj me procesin e përshpejtuar të prokurimit siç më ka udhëzuar eprori, duke i anashkaluar parregullsitë dhe problemet. Në fund të fundit, firma do të jetë ajo e eprorit, kështu që unë nuk kam përgjegjësi.
- 4 Nuk do të flas për problemet që kam identifikuar në mënyrë që të shmang përplasjet me eprorin tim.

SHTOJCA IV. SKENARI B PËR GRUPIN E KONTROLLIT. PROCESI ETIK I PROKURIMIT (NXITËSI I ENTUZIAZMIT)

Jeni një nëpunës i përkushtuar që punon në drejtorinë e prokurimeve në administratën publike. Drejtoria juaj është përgjegjëse për të garantuar që të gjitha proceset e prokurimit të kryhen me integritetin maksimal dhe në respekt të plotë të rregullave dhe rregulloreve në fuqi. Një ditë, ju vjen një email nga eprori juaj, i cili ka kompetencat për të miratuar të gjitha vendimet e prokurimit. Në email bëhet një kërkesë për të përshpejtuar një kontratë prokurimi për një projekt madhor. Eprori ju informon se kjo kontratë është me shumë leverdi për institucionin dhe ka presione të mëdha që vijnë nga eprorët në nivele më të larta për ta mbyllur sa më shpejt si procedurë.

Teksa shqyrtoni me kujdes dokumentet e prokurimit dhe kriteret e vlerësimit, vini re çdo gjë duket se është në rregull:

1. Ofertuesi fitues, Shoqëria A, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara për kontratën.
2. Procesi i tenderimit ishte i hapur dhe konkurrues siç kërkohet me rregullore, ku u morën shumë oferta dhe propozimi i dërguar nga Shoqëria A ishte më konkurruesi.
3. Është e qartë se eprori juaj i ka ndjekur të gjitha procedurat e prokurimit me rigorozitet dhe nuk ka të dhëna për favorizime të ndonjë subjekti konkurrues.
4. Kushtet e propozuara të kontratës janë të paanshme dhe në interesin më të mirë të administratës publike.

Çfarë qëndrimi do të mbani? (Edhe në Shtojcën C)

1. Mund të vendosni të vazhdoni me procesin e përshpejtuar të prokurimit siç udhëzohet nga eprori juaj, duke ditur që të gjitha procedurat janë ndjekur në mënyrë korrekte.
2. Mund të informoni eprorin se i keni shqyrtuar dokumentet e prokurimit dhe jeni të kënaqur me integritetin e procesit.
3. Mund të vazhdoni me procesin e përshpejtuar të prokurimit sipas udhëzimeve të eprorit, por me rezerva për shkak të presionit nga drejtuesit e nivelit më të lartë.
4. Mund të vendosni të mos flisni për situatën për të shmangur përplasjet me eprorin, edhe pse nuk keni shqetësime etike.

Çdo pyetje e mësipërme ka një përgjigje sa më poshtë: (Kjo pjesë sikurse dhe në grupin e eksperimentit nuk u nda me të anketuarit.)

Opsioni 1: Respektoni integritetin dhe vazhdoni me procedurat sipas udhëzimit të eprorit.

Opsioni 2: Informoni eprorin se sa të kënaqur jeni me procesin.

Opsioni 3: Komprometoni integritetin dhe vazhdoni më tej me rezerva.

Opsioni 4: Nuk flisni për situatën.

Në këtë skenar, procesi i prokurimit është kryer në mënyrë korrekte dhe nëpunësit publikë morën vendime bazuar në integritetin e tyre dhe respektimin e standardeve etike. Ky version i skenarit mund të ndihmojë në vlerësimin e nivelit të integritetit dhe vendimmarrjes etike të pjesëmarrësve kur nuk ka parregullsi të dukshme në procesin e prokurimit.

SHTOJCA V – PYETËSORI POST- EKSPERIMENT PËR GRUPIN E KONTROLLIT

1. Si ju bën të ndjeheni informacioni në lidhje me procedurën e prokurimit? Sa entuziast, krenar, plot shpresë, apo i qetë ndjeheni?

- 1 Aspak
- 2 Jo shumë
- 3 Disi
- 4 Shumë
- 5 Nuk e di/ i(e) pasigurt

2. Nëse kjo situatë bëhet publike, sa kohë keni ndërmend të shpenzoni në javën e ardhshme për të marrë informacione më të hollësishme lidhur me këtë çështje? (p.sh. kohë për leximin e gazetave, ndjekjen e TV-së, përdorimin e internetit, studim i mëtejshëm i kuadrit ligjor).

- 1 Do të dëgjoj çdo ditë lajmet që lidhen me këtë çështje
- 2 Nëse dëgjoj lajme rastësisht do të ishte mirë
- 3 Neutral
- 4 Kam shumë pak interes në lidhje me këtë çështje
- 5 Nuk kam fare interes

3. Ju lutemi rendisni disa çështje të administratës publike të cilat ju shqetësojnë dhe për të cilat mendoni se duhen diskutuar në media.

4. Çfarë qëndrimi do të mbani në lidhje me procedurën që patë në video?

- 1 Do të vazhdoj me procesin e përshpejtuar të prokurimit, siç udhëzohet nga eprori im, duke ditur që të gjitha procedurat janë ndjekur në mënyrë korrekte.
- 2 Do të informoj eprorin se i kam shqyrtuar dokumentet e prokurimit dhe jam i/e kënaqur me integritetin e procesit.
- 3 Do të vazhdoj me procesin e përshpejtuar të prokurimit sipas udhëzimeve të eprorit, por me rezerva për shkak të presionit nga drejtuesit e nivelit më të lartë.
- 4 Do të vendos të mos flas për situatën për të shmangur përplasjet me eprorin, edhe pse nuk kam dyshime etike.

SHTOJCA VI – TABELAT E ANALIZËS

Tabela 2. Analiza ANOVA e variablit “emocionet e përjetuara”

Emocionet e krijuara					
	Shuma e katrorëve	df	Katrori mesatar	F	Sig.
Mes grupeve	9.115	1	9.115	8.683	.005
Brenda grupeve	59.834	57	1.050		
Gjithsej	68.949	58			

Tabela 3. Përjetimi i lajmit dhe përcaktimi i shkallës së informimit

Variabli i Varur: Shkalla e Informimit						
Burimi	Shuma e katrorëve	df	Mesatarja e katrorëve	F – Statistikor	P-Vlera	ETA e pjeshme katrore
Modeli	110.269	6	18.378	61.918	.000	.875***
Emocionet e Krijuara	94.007	3	31.336	105.574	.000	.857***
Emocionet Sipas Grupeve	1.340	3	.447	1.505	.224	.079
(Kontrolli/Eksperimenti)						
Gabimi	15.731	53	.297			
Gjithsej	126.000	59				
R katror = .875 (R katror i përshtatur = .861)						

Tabela 4. ANOVA- Indeksi i integritetit dhe njohurive politike dhe raporti me shkallën e emocionit

Variabli i Shpjeguar: Emocionet						
	Shuma e katrorëve	df	Mesatarja e katrorëve	F – Statistikor	Vlera P-	Koeficienti i ndikimit (ETA e pjeshme)
Modeli	111.480	8	13.935	51.536	.000	.892***
Emocionet e Krijuara	3.491	3	1.164	4.303	.009	.205***
Shkalla e Njohurive Politike	1.099	1	1.099	4.065	.049	.075**
Integriteti dhe Etika	.075	1	.075	.277	.601	.006
Emocionet e Krijuara sipas Grupeve te Eksperimentit	1.876	3	.625	2.313	.087	.122*
Gabimi	13.520	50	.270			
Gjithsej	125.000	58				
R katror = .892 (R katror i përshtatur = .875)						

